# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada – Government*

**Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice**

---

# UDHËZIM ADMINISTRATIV[1]
# MD-NR. 06/2013
# PËR KARTELËN IDENTIFIKUESE TË PËRMBARUESIT PRIVAT

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION[2]
# MoJ-NO. 06/2013
# ON IDENTIFICATION CARD OF PRIVATE ENFORCEMENT AGENTS

# ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO[3]
# MP-BR. 06/2013
# O IDENTIFIKACIONOJ KARTICI PRIVATNOG IZVRŠITELJA

---

[1] Udhëzim Administrativ MD-NR. 06/2013 për kartelën identifikuese të përmbaruesit privat, është nënshkruar nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, me datë 22.10.2013.

[2] Administrative Instruction MoJ-NO.06/2013 on identification card of private enforcement agents, is signed by the Deputy Prime Minister and Minister of Justice, date 22.10.2013.

[3] Administrativno Uputstvo MP-BR.06/2013 o identifikacionoj kartici privatnog izvršitelja, je potpisano od strane Potpredsednik Vlade i Ministra Pravde, datum 22.10.2013.

| | | |
|---|---|---|
| **Ministri i Ministrisë së Drejtësisë,**<br><br>Në mbështetje të nenit 333 paragrafi 4, të Ligjit Nr. 04/L-139 (GZ NR. 3, me datë 31.01.2013) për Procedurën Përmbarimore, nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),<br><br>Nxjerrë:<br><br>**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 06/2013 PËR KARTELËN IDENTIFIKUESE TË PËRMBARUESIT PRIVAT**<br><br>**Neni 1**<br>**Qëllimi dhe Fushëveprimi**<br><br>1. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet forma, përmbajtja dhe mënyra e lëshimit të kartelës identifikuese për përmbaruesit privat.<br><br>2. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ përshtatshmërisht vlejnë për zëvendësuesit dhe zëvendësit e përmbaruesit privat. | **Minister of the Ministry of Justice,**<br><br>Pursuant to article 333, paragraph 4 of the Law no. 04/L-139 (Official Gazette no. 3, dated 31.01.2013) on Enforcement Procedure, article 8 subparagraph 1.4 of the Regulation no. 02/2011 on Areas of Administrative Responsibilities of the Prime Minister's Office and Ministries and article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (Official Gazette no. 15, 12.09.2011),<br><br>Issues:<br><br>**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MD-NO. 06/2013 ON IDENTIFICATION CARD OF PRIVATE ENFORCEMENT AGENTS**<br><br>**Article 1**<br>**Objective and scope**<br><br>1. This Administrative Instruction determines the form, content, issuance and suspension of the ID card of Private enforcement agent.<br><br>2. Provisions of this Administrative Instruction shall accordingly apply for deputy and replacer of the private enforcement agent. | **Ministar Ministarstva Pravde,**<br><br>U skladu sa članom 333 stavom 4. Zakona br. 04/L-139 (SL Br. 3 od 31.01.2013.) o izvršnom postupku, članu 8. tački 1.4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativnih nadležnosti kancelarije premijera i ministarstava kao i člana 38. stava 6. Poslovnika o radu Vlade Br. 09/2011 (Službeni list br. 15, 12.09.2011),<br><br>Donosi:<br><br>**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MD-BR. 06/2013 O IDENTIFIKACIONOJ KARTICI PRIVATNOG IZVRŠITELJA**<br><br>**Član 1**<br>**Svrha i delokrug**<br><br>1. Ovim Administrativnim uputstvom se utvrđuje oblik, sadržaj, način izdavanja i suspenzija identifikacione kartice za privatnog izvršitelja.<br><br>2. Odredbe ovog Administrativnog uputstva na odgovarajući način važe i za zamenu i zamenike privatnog izvršitelja. |

| Neni 2<br>**Kartela identifikuese** | Article 2<br>**Identification Card** | Član 2<br>**Identifikaciona kartica** |
|---|---|---|
| 1. Kartela identifikuese është dokument zyrtar që tregon identitetin e përmbaruesit privat dhe shërben si dëshmi për kryerjen e autorizimeve publike, sipas kompetencave të parapara me Ligjin për Procedurën Përmbarimore**.** | 1. Identification card shall be an official document indicating the identity of the private enforcement agent and shall serve as a proof during performing public authorizations, according to competencies provided by Law on Enforcement Procedure. | 1. Identifikaciona kartica je zvanični dokument koji pokazuje identitet privatnog izvršitelja i služi za izvršenje javnih ovlašćenja, prema nadležnostima predviđenim Zakonom o izvršnom postupku**.** |
| 2. Kartela identifikuese është e punuar si kartelë plastike në formë katërkëndëshi, ngjyrë e kaltër me dimensione 85x55 (gjerësia x lartësia). | 2. ID Card shall be printed on blue quadrate plastic card, size 85x55 mm (width x height). | 2. Identifikaciona kartica je izrađena kao plastična kartica u obliku četvorougla, plave boje u dimenzijama 85x55 (dužina x širina). |
| 3. Kartela identifikuese do të zëvendësohet në rast se humbet, dëmtohet apo ka nevojë të ndryshohen të dhënat. | 3. ID card shall be replaced in case it is lost, damaged or if needed to amend the information contained in it. | 3. Identifikaciona kartica će biti zamenjena u slučaju gubitka, oštećenja ili ukoliko je potrebno promeniti podatke. |
| 4. Përmbaruesi privat pajiset me kartelë identifikuese nga Ministria e Drejtësisë, para ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë. | 4. Private enforcement agent shall be provided with ID card by the Ministry of Justice before starting to exercise enforcement activities. | 4. Ministarstvo Pravde izdaje identifikacionu karticu privatnom izvršitelju pre datuma početka obavljanja delatnosti. |
| **Neni 3**<br>**Përmbajtja e kartelës** | **Article 3**<br>**Content of the Card** | **Član 3**<br>**Sadržaj kartice** |
| 1. Kartela identifikuese në pjesën e përparme përmban këto të dhëna: | 1. The following information shall be indicated in the front side of the card: | 1. Identifikaciona kartica sadrži sledeće podatke na prednjem delu: |
| 1.1 stemën e Republikës së Kosovës (ana e majtë); | 1.1 coat of arms of the Republic of Kosovo (left side); | 1.1 grb Republike Kosovo (leva strana); |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2 tekstin: Republika e Kosovës; | 1.2 text: Republic of Kosovo; | 1.2 tekst Republika Kosovo; |
| 1.3 shenjën e përmbarimit (ana e djathtë); | 1.3 enforcement logo (right side); | 1.3 oznaku izvršitelja (desna strana); |
| 1.4 fotografinë e përmbaruesit privat; | 1.4 photo of Private Enforcement Agent; | 1.4 fotografiju privatnog izvršitelja; |
| 1.5 emrin dhe mbiemrin e përmbaruesit privat; | 1.5 name and surname of Private Enforcement Agent; | 1.5 ime i prezime privatnog izvršitelja; |
| 1.6 pozitën; | 1.6 position; | 1.6 položaj; |
| 1.7 numrin identifikues të kartelës së përmbaruesit privat, dhe | 1.7 private Enforcement Agent ID card number, and | 1.7 identifikacioni broj kartice privatnog izvršitelja, i |
| 1.8 selinë e zyrës së përmbaruesit privat. | 1.8 seat of Private Enforcement Agent's office. | 1.8 sedište kancelarije privatnog izvršitelja. |
| 2. Kartela identifikuese në pjesën e prapme përmban këto të dhëna: | 2. The following information shall be indicated in the back side of the card: | 2. identifikaciona kartica sadrži sledeće podatke na poleđini: |
| 2.1 tekstin: ,,Mbajtësi i kësaj kartele identifikuese ka të drejta dhe autorizime të parapara me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore”. | 2.1 text: "Holder of this ID Card shall enjoy rights and authorizations as provided by the Law on Enforcement Procedure". | 2.1 tekst: „Nosilac ove kartice nosi prava i ovlašćenja propisana Zakonom o izvršnom postupku“. |
| 2.2 data e lëshimit, dhe | 2.2 Issue date, and | 2.2 datum izdavanja, i |
| 2.3 tekstin: ,,E lëshuar nga Ministria e Drejtësisë’’. | 2.3 text: "Issued by the Ministry of Justice". | 2.3 tekst: „Izdaje Ministarstvo Pravde“. |
| 3. Kartela identifikuese lëshohet sipas | 3. ID card shall be issued according to the | 3. Identifikaciona kartica se izdaje na |

| | | |
|---|---|---|
| formularit i cili është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi administrativ.<br><br>4. Kartela identifikuese duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. | form which is integral part of this Administrative Instruction.<br><br>4. ID card shall be printed in official languages of Republic of Kosovo. | osnovu obrasca koji je sastavni deo ovog Administrativnog uputstva.<br><br>4. Identifikaciona kartica je na službenim jezicima u Republici Kosovo. |
| **Neni 4**<br>**Evidenca e mbajtjes së kartelës identifikuese** | **Article 4**<br>**Records of ID Cards issued** | **Član 4**<br>**Registar nosilaca identifikacionih kartica** |
| 1. Evidenca mbi lëshimin e kartelës identifikuese mbahet nga Ministria e Drejtësisë. Evidenca duhet të përmbaj:<br><br>1.1 emrin dhe mbiemrin e përmbaruesit privat;<br><br>1.2 emrin e territorit të Gjykatës themelore ku ushtron veprimtarinë përmbaruesi privat;<br><br>1.3 numrin e regjistrit të kartelës identifikuese;<br><br>1.4 datën e lëshimit, dhe<br><br>1.5 datën e skadimit. | 1. The Ministry of Justice shall keep records of ID Cards issues. The record shall contain:<br><br>1.1 name and surname of private enforcement agent;<br><br>1.2territory of Basic Court where private enforcement agent exercises its activities;<br><br>1.3 registry number of the ID Card;<br><br>1.4 issue date, and<br><br>1.5 expiry date. | 1. Registar o izdatim identifikacionim karticama se drži u ministarstvu pravde. Registar mora sadržavati:<br><br>1.1 ime i prezime privatnog izvršitelja;<br><br>1.2 naziv teritorije Osnovnog suda u kojoj privatni izvršitelj obavlja delatnost;<br><br>1.3 broj registra identifikacione kartice;<br><br>1.4 datum izdavanja; i<br><br>1.5 datum isteka. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 5**<br>**Përdorimi i kartelës identifikuese**<br><br>1. Përmbaruesi privat në bazë të detyrave dhe autorizimeve ligjore të parapara me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore mbanë kartelën identifikuese në një vend të dukshëm ku mund të shihet, dhe e prezanton sa herë që nevojitet për identifikim.<br><br>2. Kartela identifikuese përdoret vetëm në fushëveprimin e autorizimeve ligjore të kryerjes së veprimeve të përmbarimit.<br><br>3. Për keqpërdorimin e kartelës identifikuese, përgjegjës është përmbaruesi privat.<br><br>4. Është e ndaluar dhënia e kartelës identifikuese personave tjerë në shfrytëzim.<br><br>**Neni 6**<br>**Vjedhja, humbja apo dëmtimi i kartelës identifikuese**<br><br>1. Në rastet kur kartela identifikuese e përmbaruesit privat vidhet, humbet apo dëmtohet, përmbaruesi privat duhet që sa më shpejtë që është e mundur ta njoftoj Ministrinë e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë para se t'ia lëshoj përmbaruesit | **Article 5**<br>**Use of ID card**<br><br>1. Private enforcement agent pursuant to legal duties and authorities provided by the Law on Enforcement procedure, shall hold the ID card on visible position, and shall present the ID Card for presentation whenever needed.<br><br>2. ID Card may be used only in the scope of legal authorizations upon performing enforcement.<br><br>3. The private enforcement agent shall be held liable for abuse of the ID card.<br><br>4. ID Card is not transferable.<br><br>**Article 6**<br>**Theft, loss or damage of ID card**<br><br>1. In event the ID Card is stolen, lost or damaged, private enforcement agent shall as soon as possible notify the Ministry of Justice. Before issuing the new ID Card to private enforcement agent, Ministry of Justice shall declare the old ID card invalid | **Član 5**<br>**Korišćenje identifikacione kartice**<br><br>1. Privatni izvršitelj, na osnovu zakonskih nadležnosti i ovlašćenja propisanih odredbama Zakona o izvršnom postupku, nosi identifikacionu karticu na vidljivom mestu i predstavlja je u svakom slučaju kada je potrebno za legitimisanje.<br><br>2. Identifikaciona kartica se koristi samo za oblast zakonskih ovlašćenja za obavljanje delatnosti izvršenja.<br><br>3. Privatni izvršitelj snosi odgovornost za zloupotrebu identifikacione kartice.<br><br>4. Zabranjeno je davanje identifikacione kartice za korišćenje drugim licima.<br><br>**Član 6**<br>**Krađa, gubitak ili oštećenje identifikacione kartice**<br><br>1. U slučajevima kada dođe do krađe, gubitka ili oštećenja identifikacione kartice privatni izvršitelj je dužan da što je pre moguće obavesti Ministarstvo pravde. Za izdavanja nove identifikacione kartice izvršitelju, Ministarstvo Pravde je prvo |

| | | |
|---|---|---|
| privat kartelën identifikuese të re, së pari duhet ta shpall të pavlefshme kartelën e vjetër në njërën nga gazetat ditore. Shpenzimet për shpalljen e pavlefshme të kartelës i bartë përmbaruesit privat.<br>2. Në rast kur përmbaruesit privat i pushon funksioni, kartela identifikuese duhet t'i kthehet Ministrisë së Drejtësisë.<br><br>**Neni 7**<br>**Vlefshmëria e kartelës identifikuese**<br><br>Kartela identifikuese vlen nga data e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbaruese e deri në skadimin e autorizimit për kryerjen e autorizimeve publike.<br><br>**Neni 8**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.<br><br>Prof. Dr. Hajredin Kuçi<br>____________________<br>**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë**<br><br>22.10.2013 | through advertisement in one of the daily papers. Expenses for invalidating the ID card shall be covered by the private enforcement agent.<br><br>2. In event private enforcement agent ceases to exercise his functioning, the ID card shall be returned to the Ministry of Justice.<br><br>**Article 7**<br>**Validity of ID card**<br><br>ID Card shall be valid from the date the agent starts exercising the duties of the private enforcement agent, until the expiry date of the authority to perform public authorities.<br><br>**Article 8**<br>**Entry into force**<br><br>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after signature of the Minister.<br><br>Prof. Dr. Hajredin Kuçi<br>____________________<br>**Deputy Prime Minister and Minister of Justice**<br><br>22.10.2013 | dužno da u jednoj od dnevnih novina staru karticu proglasi nevažećom. Troškove oglašavanja nevažeće kartice snosi privatni izvršitelj.<br><br>2. U slučajevima kada privatnim izvršiteljima prestane funkcija identifikaciona kartica mora biti vraćena Ministarstvu Pravde.<br><br>**Član 7**<br>**Rok važenja identifikacione kartice**<br><br>Identifikaciona kartica važi od dana počinjanja obavljanja izvršne delatnosti do dana isteka ovlašćenja za obavljanje javnih ovlašćenja.<br><br>**Član 8**<br>**Stupanje na snagu**<br><br>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od potpisa Ministra.<br><br>Prof. dr Hajredin Kuçi<br>____________________<br>**Potpredsednik Vlade i Ministar Pravde**<br><br>22.10.2013 |

**Formulari 1**

Ana e përparme e Kartelës identifikuese

| | |
|---|---|
| Stema e Republikës së Kosovës<br>Republika e Kosovës<br>Shenja e Përmbarimit | Fotografia 20x25 mm |
| Emri e Mbiemri:<br><br>Pozita:<br>Numri i Kartelës:<br>Selia: | |

Pjesa e pasme e Kartelës identifikuese

| |
|---|
| “Mbajtësi i kësaj kartele ka të drejta dhe autorizime të parapara me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore”<br><br>Data e lëshimit;<br><br>E lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. |

**Form 1**

Front side of the ID Card

| | |
|---|---|
| Coat of arms of the Republic of Kosovo<br>Republic of Kosovo<br>Enforcement logo | Photo 20x25mm |
| Name and surname:<br><br>Position:<br>ID card no:<br>Seat: | |

Back side of the ID Card

"Holder of this Card shall enjoy rights and authorities as provided by the Law on Enforcement Procedure".

Issue date:

Issued by the Ministry of Justice.

**Obrazac 1**

Prednja strana identifikacione kartice

| | |
|---|---|
| Grb Republike Kosovo<br>Republika Kosovo<br>Oznaka izvršitelja | Fotografija 20x25 mm |
| Ime i prezime:<br><br>Položaj:<br>Broj kartice:<br>Sedište: | |

Poleđina identifikacione kartice

| |
|---|
| „Nosilac ove kartice nosi prava i ovlašćenja propisana Zakonom o izvršnom postupku“<br><br>Datum izdavanja;<br><br>Izdaje Ministarstvo pravde. |